

**RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR
PER AKSIONERET E Tirana Factoring & Lease Sh.a**

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUAR

Drejtuar: Aksionerëve të shoqërisë "Tirana Factoring & Lease "sh.a
Bulevardi Zogu I-rë, P. Kirchberger, kati 8
Tiranë

Të nderuar Zotërinj,

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë "Tirana Factoring & Lease "sh.a , të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 Dhjetor 2014 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë, për vitin ushtrimor të përfunduar në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajne anomalitë materiale, qoftë edhe për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë, është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare, bazuar në procedurat e auditimit. Ne e kemi kryer auditimin, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin, nëse pasqyrat financiare janë pa anomalitë materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të entitetit, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të tij. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmerisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyetueshmërisë së çmuarjeve kontabël të kryera nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqisin në të gjitha aspektet materiale një pamje të vërtetë dhe të drejtë për gjendjen financiare të shoqërisë "Tirana Factoring & Lease " sh.a me datë 31 Dhjetor 2014, për ecurinë financiare të saj dhe flukset e parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Vera Lala

Ekspert Kontabël i Regjistruar

Adresa: Blv. "Zhan D'Ark",
Rr. "Fadil Rada", Ap.1, Sh.2, pranë ATSH-së,
Tiranë

Tiranë, me 02 Mars 2015



Vjollca Dervishi

Ekspert Kontabël i Regjistruar

Rruga "Frederik Shiroka", Kulla I, Kati I,
Seksioni C, Nr. C/4
Tiranë





**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

Shënime	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2014		Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	
		LEK		LEK
Të ardhura nga interesi	4	8,175,386		1,910,451
Shpenzime për interesa	4	0		-427,015
Të ardhura neto nga interesat		8,175,386		1,483,436
Të ardhura nga komisionet	5	4,323,761		1,117,938
Shpenzime për komisionet	5	-41,537		-20,944
Të ardhura neto nga komisionet		4,282,224		1,096,994
Të ardhura të tjera		0		
Fitimi neto nga këmbimet valutore		14,712		-2,376
Të ardhura të tjera operative		14,712		-2,376
Provizione per mbulimin e humbjeve nga huate	6	-1,125,137		-295,063
Amortizimi i aktiveve materiale	7	-18,150		-8,499
Amortizimi i aktiveve jo-materiale	7	-21,242		0
Shpenzime personeli	8	-2,217,903		-1,693,318
Shpenzime administrative	9	-844,053		-237,777
		-4,226,485		-2,234,657
Fitimi para fitimit		8,245,838		343,397
Tatimi mbi fitimin	10	-1,441,793		-40,587
E ardhur nga Tatim Fitimi I shtyre	11	213,030		
Fitimi për periudhën		7,017,075		302,810
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi mbi fitimin		0		0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën që i atribuohet aksionerëve	12	7,017,075		302,810

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në faqet 5 deri ne 26 janë një pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare dhe u miratuan nga Drejtuesi i Tirana Factoring & Lease Sh.a dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

**Endrit Beqaj
Administrator**

Endrit Beqaj

**Ervin Kosta
Specialist Finance**

Ervin Kosta





Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2014

Shenime	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013	
	LEK	LEK	
Aktive			
Aktive Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale dhe jomateriale	7	150,986	72,601
Totali i aktiveve Afatgjata		150,986	72,601
Aktive Afatshkurtra			
Aktive tatimore te shtyra (neto)	11	213,030	0
Aktive të tjera	13	4,203	239,896
Te drejta ndaj shtetit	14	0	0
Hua dhe paradhënie klientëve	6	132,598,631	29,211,229
Aktive monetare dhe ekuivalentët me to	15	18,052,399	4,271,505
Totali i aktiveve Afatshkurtra		150,868,263	33,722,630
Total aktive		151,019,249	33,795,231
Kapitali dhe detyrimet			
Kapitali aksioner			
Kapitali i paguar	16	28,000,000	22,000,000
Fitime të pashpërndara	12	6,933,618	-83,457
Totali i kapitalit		34,933,618	21,916,543
Detyrime afatgjata		0	0
Detyrime afatshkurtra			
Hua nga bankat dhe te tjera	17	114,486,344	11,179,708
Detyrime të tjera	18	169,701	596,899
Detyrime tatimore	19	1,429,587	102,081
Totali i detyrimeve		116,085,631	11,878,688
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		151,019,249	33,795,231

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në faqet 5 deri ne 26 janë një pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare dhe u miratuan nga Drejtuesi i Tirana Factoring & Lease Sh.a. dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Endrit Beqaj
Administrator

Ervin Kosta
Specialist Finance





**Pasqyra e ndryshimit në kapital
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

Kapitali	Kapitali i paguar	Fitime te pashperndar a	Totali
	LEK	LEK	LEK
Gjendja në 1 Janar 2013	22,000,000	-386,267	21,613,733
Emetim kapitali			0
Fitimi i vitit	0	302,810	302,810
Të ardhura të tjera, neto nga tatimi mbi të ardhurat	0	0	0
Totali i të ardhurave permbledhese për periudhën	22,000,000	-83,457	21,916,543
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	-	0	-
Gjendja në 31 Dhjetor 2013	22,000,000	-83,457	21,916,543
Emetim kapitali	6,000,000		6,000,000
Fitimi i vitit	-	7,017,075	7,017,075
Të ardhura të tjera, neto nga tatimi mbi të ardhurat	-	-	0
Totali i të ardhurave permbledhese për periudhën	28,000,000	6,933,618	34,933,618
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë	-	0	-
Gjendja në 31 Dhjetor 2014	28,000,000	6,933,618	34,933,618

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në faqet 5 deri ne 26 janë një pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare dhe u miratuan nga Drejtuesi i Tirana Factoring & Lease Sh.a. dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Endrit Beqaj
Administrator

Ervin Kosta
Specialist Finance

Endrit Beqaj

Ervin Kosta




Pasqyrat financiare te vitit 2014

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Flukset monetare nga aktivitetet operative		
Fitimi i periudhes	8,245,838	343,397
<i>Rregullimet për:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7 39,392	8,499
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve ndaj klientëve	6 1,125,137	295,063
Të ardhura nga interesat, komisione neto	4 -12,499,147	-1,483,436
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	8 1,441,793	40,587
Provizione për tatimet e shtyra	24 -213,030	0
Diferencat e porealizuara nga kurset e kembimit	-17,157	2,337
	-1,877,174	-793,553
Ndryshime në hua	10,11 -103,387,402	-29,340,233
Ndryshime në aktive të tjera	14 22,663	-182,270
Ndryshime në hua dhe paradhënie dhënë bankave dhe institucioneve të tjere financiar	15 103,306,636	10,270,626
Ndryshime në detyrimet tatimore	16 -38,627	
Ndryshime në detyrime të tjera	17 -427,198	592,230
Interesi i arkëtuar	10,991,838	1,744,392
Interesi i paguar	-428,439	-6
Tatim fitimi i paguar	-75,660	-40,000
Flukset monetare neto, nga aktivitetet operative	8,086,637	-17,748,813
Flukset monetare përdorur në aktivitetet investuese		
Emetimi i kapitalit	6,000,000	2,000,000
Blerja e aktiveve materiale	12 -117,777	-81,100
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese	5,882,223	1,918,900
Flukset monetare neto nga aktivitetet financiare	0	0
Rritje neto në aktivet monetare dhe ekuivalentët me to	13,968,860	-15,829,913
Aktivitet monetare dhe ekuivalentët me to në 1 Janar	9 4,271,505	20,187,630
Efekt i ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi aktivet monetare dhe ekuivalentët me to	9 -187,966	-86,212
Aktivitet monetare dhe ekuivalent më 31 Dhjetor	18,052,399	4,271,505

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në faqet 5 deri në 26 janë një pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare dhe u miratuan nga Drejtuesi i Tirana Factoring & Lease Sh.a. dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Endrit Beqaj
Administrator

Endrit Beqaj


Ervin Kosta
Specialist Finance

Ervin Kosta




Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Tirana Factoring & Lease sh.a është regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me NUIS L21811017F date 11.06.2012 dhe është licensuar nga Banka e Shqiperise për të ushtruar aktivitetin e Faktoringut, si një institucion financiar Jo banke, në përputhje me ligjin nr. 8269, date 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar , me licensen nr. 27, date 28 Mars 2013.

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj faktoringun vendas dhe/ose nderkombetar me ose pa garanci, mbajtja dhe/ose mbledhja e llogarive klient si dhe cdo veprimtari tjetër qe lidhet me transaksionet e faktoring. Ushtrim i qerase financiare te njohur si Leasing Financiar dhe Leasing Operacional (eshte ne procesin e marrjes se licenses perkatese nga Banka e Shqiperise). Objekti i shoqerise do te perfsijhe sherbime keshilluese, ndermjetese dhe sherbime te tjera ndihmese per aktivitetin kryesor.

Administrator i shoqerise eshte z. Endri Beqaj, me afat emerimi deri me 13.10.2017.

Anetare te Keshillit Mbikqyres jane: Z. Roland Manushi, z. Ervin Aliaj dhe z. Saimir Hasaj me afat emerimi deri me 13.10.2017.

Tirana Factoring & Lease sh.a operon në zyrën e saj Bulevardi Zogu I-se, Pal. Kirchberger kati 8, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2014 shoqeria kishte 2 punonjës (31 dhjetor 2013: 2 punonjës).

1. Politikat kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Leke.

(i) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqerise janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

(ii) Paraqitja e pasqyrave financiare

Shoqeria e paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqeria gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto ne Pasqyren Permbledhese te te ardhurave vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Shoqerise.

2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël te shoqerise, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe vlerësimeve janë si vijon:

(i) Parimi i vijimësisë

Drejtimi i shoqerise ka kryer një vlerësim të aftësisë së shoqerise për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që shoqeria ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqerise për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(ii) Vlera e drejtë e instrumentave financiarë

Politika kontabël e shoqërisë lidhur me vlerësimin me vlerën e drejtë është diskutuar në Përmbledhje e Politikave të Rëndësishme Kontabël 2.4(IV). Shoqëria e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuar për instrumenta të ngjashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat mes instrumentave.

(iii) Humbjet nga zhvlerësimi i huave

Shoqëria rishikon portofolet e saj të huave në baza tremujore për të vlerësuar zhvlerësimin.

Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, shoqëria bën gjykime për të parë nëse ka ndonjë të dhënë të vrojtueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të pritshme në portofolin e huave dhe investimeve të tjera financiare para se rënia të mund të identifikohet me një kredi individuale ose investim tjetër.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e vrojtueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në një Shoqëri, ose kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e huave nga huamarrësit.

(iv) Tatimet

Ekzistojnë pasiguri në lidhje me interpretimin e rregulloreve tatimore komplekse, ndryshimet në ligjet tatimore, si dhe në sasinë dhe shtrirjen e të ardhurave të tatueshme të ardhme. Diferencat që dalin nga rezultatet aktuale dhe atyre të parashikuara, mund të kërkojnë sistemime të mëpasshme të tatim fitimit dhe shpenzimit të regjistruar aktual. Shoqëria regjistron provizione bazuar në vlerësime të arsyeshme për pasojat të mundshme të kontrolleve tatimore nga autoritetet tatimore. Shuma e këtyre provizioneve bazohet në faktorë të ndryshëm, si eksperiencat nga kontrollet tatimore të mëparshme, ndryshimi në interpretimet e rregulloreve tatimore nga shoqëria dhe nga autoriteti përgjegjës tatimor.

Aktivitetet tatimore të shtyra njihen në lidhje me humbjet tatimore deri në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet mund të përdoren. Gjykimi është i nevojshëm për të përcaktuar shumën e aktiveve tatimore të shtyra që mund të njihen, bazuar në kohën e mundshme dhe nivelin e fitimit të tatueshëm të ardhshëm, së bashku me strategjitë e ardhshme të planifikimit tatimor.

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar. Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e shoqërisë.

Deklarata të reja (standarde të reja, ndryshimet/rishikimet e standardeve ose interpretimeve të tyre) të publikuara për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2014



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

Standardet e publikuara një pjesë e të cilave ka hyrë në fuqi apo pritet të hyjnë në fuqi në datën e publikimit të pasqyrave financiare, janë të listuara më poshtë. Ky është një listim i standardeve dhe interpretimeve të publikuara, të cilat Shoqëria në mënyrë të arsyeshme pret të jenë të aplikueshme në një datë të ardhme. Shoqëria pret të adoptojë këto standarde kur ato të hyjnë në fuqi.

- **SNK 32 Instrumentet Financiare: Paraqitja (e rishikuar) - Shuarja e Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare**

Rishikimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2014. Ky ndryshim sqaron kuptimin e "aktualisht ka një të drejtë ligjore që të kryej një kompensim" dhe gjithashtu sqaron aplikimin e kritereve kompensuese të SNK 32 në sistemet e shlyerjes të cilat zbatohen mekanizma të zgjidhjes bruto që nuk janë të njëkohshëm. Njësia ekonomike duhet të zbatohet ndryshimet në mënyrë retrospektive. Lejohet zbatimi më i hershëm. Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe gjithashtu do të japë shpjegimet e kërkuara nga SNRF 7 Dhënie informacionesh shpjeguese- Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Pasiveve Financiare. Adoptimi i ketij ketij rishikimi nuk do të ketë impakt në pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërisë.

- **SNRF 9 Instrumentet Financiare – Klasifikimi dhe Matja**

Standarti i ri është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2015. SNRF 9, pasqyron fazën e parë të punës së BSNK-se për zëvendësimin e SNK 39 dhe zbatohet për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare, siç përcaktohet në SNK 39. Faza e parë e SNRF 9 do të ketë një ndikim të rëndësishëm në (i) klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe (ii) në ndryshimin në raportimin për ato subjekte që kanë të përcaktuara detyrimet financiare duke përdorur FVO. Në fazat e mëvonshme, BSNK do të trajtojë kontabilitetin mbrojtës dhe zhvlerësimin e aktiveve financiare. Zbatimi i hershem është i lejuar. Shoqëria është në proces të vlerësimit të impaktit të këtij ndryshimi në pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërisë.

- **KIRFN 21 Taksat**

Në Maj 2013, BSNK publikoi interpretimin e KIRFN 21 Tatimet i cili u zhvillua nga Komiteti i Interpretimit të SNRF-ve (Komiteti). Interpretimi sqaron se një shoqëri nje një detyrim për një takse, kur ndodh aktiviteti i cili gjeneron pagesën, sic identifikohet nga legjislacioni në fuqi. Ai gjithashtu sqaron se një detyrim tatimor është përlogaritur në mënyrë progresive vetëm në qoftë se aktiviteti i cili gjeneron pagesën ndodh për një periudhë kohore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për taksën e cila gjenerohet nga arritja e nje kufiri minimal, interpretimi sqaron se asnjë detyrim nuk duhet të njihet përpara se kufiri minimal i caktuar të arrihet. Interpretimi është i aplikueshëm për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 Janarit 2014. Aplikimi i hershem është i lejuar. Shoqëria është në procesin e vlerësimit të ndikimit të standardit të ri në pozicionin financiar apo performancën e Shoqërisë.

- **SNK 39 Zevendesimi i derivativeve dhe vazhdimi i kontabilitetit mbrojtës (i Rishikuar)**

Më 27 Qershor 2013 Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) publikoi ' Zevendesimi i derivativeve dhe vazhdimi i kontabilitetit mbrojtës' (Amendim i SNK 39 'Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja'). Bazuar në amendimet nuk do të jetë e nevojshme për të ndërprerë kontabilitetin mbrojtës nese nje derivative mbrojtës nuk eshte zevendesuar, me kusht qe te plotesohen disa kritere. hedge accounting if a hedging derivative was novated, provided certain criteria are met. Amendimi është i aplikueshëm për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2014, ku aplikimi para afatit është i lejuar. Shoqëria është në procesin e vlerësimit të ndikimit të standardit të ri në pozicionin financiar apo performancën e Shoqërisë.

- **SNK 36 Dhenia e shenimeve shpjeguese per aktivet jo-financiare (Rishikuar)**



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

BSNK, si pasojë e amendimit të SNRF 13 'Matja e vlerës së drejtë', ka ndryshuar disa nga shënimet e kërkuara në SNK 36 'Zhvlerësimi i Aktiveve', lidhur me matjen e shumave të rikuperueshme nga zhvlerësimi i aktiveve. Gjithsesi, një nga amendimet ka shume te ngjare qe rezultoi ne ate qe shenimet shpjeguese te ishin me te gjera sesa fillimisht synohej. BSNK e ka korrigjuar këtë nëpërmjet publikimit të 'Shënimeve për shumat e rikuperueshme per Akitvet jo-Financiare (Amendime të SNK 36). Efekti i përgjithshëm i amendimeve është të reduktojë rrethanat në të cilat shumat e rikuperueshme të aktiveve ose njësitë gjeneruese të mjeteve monetare kërkohet të përfshihen në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të shpjegohet shënimi i kërkuar dhe të prezantohet një kërkesë e qartë për të shpjeguar normën e skontimit të përdorur për zhvlerësim (ose kthim) kur shumat e rikuperueshme (bazuar në vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit) përcaktohet duke përdorur metoden e vlerësimit të aktualit. Aplikimi i amendimit kryhet në baza retrospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2014. Shoqëria është në procesin e vlerësimit të ndikimit të standardit të ri në pozicionin financiar apo performancën e Shoqërisë.

- **SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare:** Sqaron dallimin midis informacionit krahasues shtesë vullnetar dhe minimumin e kërkuar për informacionin krahasues. Në përgjithësi, periudha minimale e nevojshme krahasuese është periudha e mëparshme. Një njësi ekonomike duhet të përfshijë informacion krahasues në shënimet në lidhje me pasqyrat financiare kur ai vullnetarisht jep informacion krahasues përtej periudhës minimale të kërkuar krahasuese. Periudha shtesë krahasuese nuk ka nevojë të përmbajë një seri të plotë të pasqyrave financiare. Përveç kësaj, deklarata e hapjes së pozicionit financiar (i njohur si bilanc tretë) duhet të paraqitet në rrethanat e mëposhtme: kur një njësi ekonomike ndryshon politikën e saj kontabël; bën ri-deklarim retrospektive ose bën riklasifikim dhe se ndryshimi ka një efekt material në deklaratën e pozicionit financiar. Deklarata e hapjes do të jetë në fillim të periudhës së mëparshme. Megjithatë, ndryshe nga informacioni krahasues vullnetar, Shënimet përkatëse nuk është e nevojshme të shoqërojnë bilancin e tretë.
- **SNK 32 Instrumentat Financiarë: Paraqitja:** Sqaron se tatimet mbi të ardhurat që rrjedhin nga shpërndarjet tek mbajtësit e kapitalit janë të kontabilizuara në përputhje me SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat. Amendamenti heq nga SNK 32, kërkesat ekzistuese mbi të ardhurat nga tatimet dhe kërkon që njësitë ekonomike të zbatojnë kërkesat në SNK 12 për çdo tatim mbi të ardhurat që rrjedh nga shpërndarjet tek zotëruesit e kapitalit.
- **SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm:** Sqaron kërkesat e SNK 34 në lidhje me informacionin për segmentin e totalit të aktiveve dhe detyrimeve për çdo segment raportues, në mënyrë që të rritet qëndrueshmëria me kërkesat në SNRF 8 Segmente Operative. Totali i aktiveve dhe detyrimeve për një segment të caktuar raportues duhet të zbulohet vetëm kur shumat i janë dhënë rregullisht shefit të vendimarrjes dhe ka pasur një ndryshim material në shumën totale të paraqitur në deklaratat financiare të vitit të mëparshëm për atë segment raportues.
- **Subjektet e Investimit (Rishikimet në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27)**
Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014 me adoptimin të hershëm të lejuar. Amendamentet zbatohen për një klasë të veçantë të biznesit që kualifikohen si subjekte të investimeve. BSNK përdor termin 'subjekt investimi' për t'iu referuar një subjekti, qëllimi i të cilit është që të investojë fonde vetëm për kthime nga vlerësimi i kapitalit, të ardhurat e investimeve ose të dyja. Një subjekt investimi duhet të vlerësojë performancën e investimeve të tij mbi bazën e vlerësimit të drejtë. Subjekte të tilla mund të përfshijnë organizatat e kapitalit privat, organizatat e kapitalit sipërmarrës, fondet e pensionit, fondet supreme të pasurisë dhe fonde të tjera investimi. Sipas SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, subjektet raportuese duhet të konsolidojnë të gjithë të investuarit që ata kontrollojnë (p.sh.: të gjitha degët). Amendamentet e subjekteve të investimit, ofrojnë një përjashtim për kushtin e konsolidimit në SNRF10 and kërkojnë që subjektet e investimit të vlerësojnë filiale të caktuara në bazë të vlerësimit të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, sesa ti konsolidojnë ato. Gjithashtu, amendamentet përcaktojnë kushte paraqitjeje për subjektet e investimit. Adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2.4 Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabel te paraqitura me poshte jane aplikuar ne menyre te vazhdueshme gjate te gjitha peridhave te paraqitura ne keto pasqyra financiare.

(i) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në datën e raportimit të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e bilancit.

Aktivt dhe detyrimet jomonetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj, rivlerësohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi ose humbja neto nga ndryshimi i kurseve të këmbimit përfshihet në shënimet shpjeguese të Pasqyrës Përmbledhëse të të Ardhurave në zërin e "Të ardhurave të tjera operative".

Kursi i këmbimit të aplikuar (nga LEK në njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore në fund viti më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 ka qënë si më poshtë :

	31 /12/ 2014	31 /12/ 2013
USD	115.23	101.86
EUR	140.14	140.2

(ii) The ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifat dhe shumat e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë bilancit të një mjete apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

(iii) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjese integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifat e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet. Shpenzime të tjera për komisionet dhe tarifat që lidhen kryesisht me komisione transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që merren shërbimet.

(iv) Pagesat e huase

Përcaktimi nëse një marrëveshje është hua, bazohet në thelbin e marrëveshjes që lidhet ndërmjet paleve.



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

Shoqeria si një huadhënës

Shoqeria transferon fondet objekt i marreveshjes faktoring dhe e klasifikon ne pasqyren e gjendjes financiare si investim financiar. Fillimi i huasë është data e rumbursimit te fondeve per palën tjetër.

Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të interesit te percaktuar ne marrëveshje. Shoqëria vlerëson krijimin e fondeve rezervë për zhvlerësimin e huase financiare, duke përdorur politikat e përdorura për zhvlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura me koston e amortizueshme (p.sh. kreditë, llogaritë e arkëtueshme), duke qënë se keto hua kanë karakteristika te ngjashme rreziku.

(v) Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

a. Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje në Pasqyrën e të Ardhurave Përmbledhëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk taten apo njihen si të zbritshëm asnjëherë.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohet nga ligji Shqiptar.

b. Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivitet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivitet të mund të rikuperohet.

Detyrimet dhe aktivitet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyron rrjedhojat tatimore që do të vijnë nga mënyra në të cilën Shoqeria pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

c. Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç kur lidhen me zërat që janë njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, ose direkt në kapital, rast në të cilin tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen edhe në të ardhurat e tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital, përkatësisht.

(vi) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese

a. Data e njohjes

Të gjithë aktivitet dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur shoqeria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

b. Matja fillestare e instrumentave financiarë



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

Shoqeria fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emetuara dhe detyrimet e varura në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur Shoqeria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Të gjitha aktivitetet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën shoqeria bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit të aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve apo detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë indirekte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

c. Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivitetet financiare klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuara:

- Mjetet monetare dhe ekuivalente
- Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

d. Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit

Klasifikimi si borxh ose kapital

Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emtuar nga shoqeria janë klasifikuar ose si detyrime financiare ose si kapital i vet në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumentave të kapitalit.

Instrumentat e kapitalit

Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet e Shoqerisë pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emetuara nga Shoqeria janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

e. Hua dhe paradhënie klientëve dhe bankave

Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, dhe që Shoqeria nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që Shoqeria ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që Shoqeria gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që shoqeria, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Llogaritja e normes efektive të interesit përfshin tarifën e paguara apo të marra, transaksione të paguara, dhe skontimet apo primet, të cilat janë pjesë integrale e normes efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto rritëse të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen, shitjen ose nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivitetit apo detyrimit financiar. Të ardhurat apo shpenzimet e interesit të përfshira në fitim ose humbje përfshijnë interesin nga aktivet ose detyrimet financiare me kosto të amortizueshme me një normë efektive të interesit.

(vi) Mosnjohja (çregjistrimi) e aktiveve dhe detyrimeve financiare

a. Aktivitetet financiare

Shoqeria nuk e njihet më një aktiv financiar (e çregjistron) nëse të drejtat kontraktuale për përfitimin e parave nga aktiviteti janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen te një njësi tjetër të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar.

Çdo interes ne aktivet financiare te transferuara që krijohet ose mbahet nga Shoqeria njihet si nje aktiv ose detyrim më vete.

a. Detyrimet financiare

Shoqeria çregjistron detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur, detyrimet e Shoqeria janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat e shërbimit, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

(viii) Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Shoqeria ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Shoqerise.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim të shlyhet midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, te mirinformuara që kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

(ix) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Në çdo datë bilanci Shoqeria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të ndryshëm nga mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuar kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Shoqeria konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilat nuk zhvlerësohen specifikisht vlerësohen kolektivisht për çdo vlerësim që ka lindur por nuk është identifikuar akoma. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuara) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidencë objektive që aktivet financiare (duke përfshirë letrat me vlerë të kapitalit neto) të jene te zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Shoqeria me kusht që Shoqeria nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktiveve të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

(x) Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to

Aktivitet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivitet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

(xi) Aktive afatgjata materiale

a. Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitet. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitet në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimit në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerë, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes, kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

b. Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që ne të ardhmen Shoqëria do të këtë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në Pasqyrën Permbledhese të të Ardhurave në momentin kur ndodhin.

c. Amortizimi

Amortizimi njihet në të fitim ose humbje në Pasqyrën e të Ardhurave Permbledhese me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivitet përveçse për aktivitet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivitet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitet. Toka nuk zhvlerësohet. Metodot e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	Jetëgjatësia	Amortizimi (%)
Pajisje elektronike dhe kompjutera	4 vite	25%
Pajisje, mobilje dhe pajisje zyre	5 vite	20%

(xii) Aktive jomateriale

Programe kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Shoqëria njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimit njihet në fitim ose humbje me normën 25% mbi vlerën e mbetur prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim.

(xiii) Përfitimet e punonjësve

a. Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

b. Leja vjetore e paguar

Shoqëria njih si detyrim shumë e përlogaritur të kostos që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

c. Sigurimet shëndetësore të punonjësve

Shoqëria gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në Shoqëri nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e papaguara janë të regjistruar si detyrime.

d. Kontribut vullnetar i pensionit per punonjesit

Shoqëria nuk ka krijuar nje Plan Pensioni Profesional per punonjesit e vet.

3. Manaxhimi i rrezikut financiar

3.1 Hyrje dhe të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë "Tirana Factoring & Lease" sha ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- risku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të "Tirana Factoring & Lease" sha ndaj çdo risku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të shoqërise.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga "Tirana Factoring & Lease" sha , për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar perputhjen me kufizimet. "Tirana Factoring & Lease" sha , nëpërmjet trajnimeve dhe standarteve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

3.2 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare te "Tirana Factoring & Lease" sha nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet klientëve, bankave, investimi neto ne qera financiare dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime të administrimit të rrezikut të kredisë, "Tirana Factoring & Lease" sha konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga vet klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

Stafi drejtues është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë duke përfshirë:

Formulimin e politikave të kreditimit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, procedurat dhe dokumentacionin ligjor, dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.

Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve kredituese, përfshire Limitet e aprovimit.

Mbikqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Komiteti Kreditimit vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, para aprovimit përfundimtar të disbursimit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces.

Kufizimi i përqëndrimit të ekspozimit ndaj palëve të treta, industrive të ndryshme, monedhave dhe maturitetit.



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

Zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të "Tirana Factoring & Lease" sha në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale.

Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industrinë e zgjedhura, rrezikut të shtetit dhe llojeve të produktëve.

Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësi të specializuara njësitë të biznesit për të zhvilluar praktikën më të mira për administrimin e riskut të kreditimit në të gjithë Shoqërinë.

Investime neto në hua

Vlerësimi i kreditit ("Credit rating") për portfolin e zhvlerësuar kolektivisht është bazuar mbi normat historike të mospagimit të llogaritura për klientë të cilët i përkasin të njëjtit sektor industri, të cilët kanë karakteristika të përbashkëta. Më poshtë paraqitet analiza e shumave bruto të investimeve neto në hua të zhvlerësuar kolektivisht sipas sektorit të industrisë për 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013.

3.2 Rreziku i kredisë	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve		
Tregti Automejetesh	29,405,540	11,406,000
Pasuri e patundshme	0	0
Industria përpunuese	0	0
Hotele dhe restorante	0	0
Shendetesi dhe Farmaceutik	29,278,000	0
Prodhim	0	0
Institucione Financiare	0	0
Transport dhe komunikim	0	0
Të tjera	73,661,923	17,981,420
Totali	132,345,463	29,387,420

Nga totali i Portfolit të investimeve neto në faktoring, që nuk janë identifikuar si të zhvlerësuar individualisht, portfoli i zhvlerësuar kolektivisht përfshin investimet neto në hua të cilat nuk janë as me vonesë dhe as të zhvlerësuar.

Hua dhe paradhënie klienteve

31 Dhjetor 2014

31 Dhjetor 2013



15

Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

	Shuma bruto	Zbritja per zhvleresim	Vlera kontabel	Shuma bruto	Zbritja per zhvleresim	Vlera kontabel
	LEK '000	LEK '000	LEK '000	LEK '000	LEK '000	LEK '000
Hua dhe paradhenie klienteve						
Te zhvleresuara kolektivisht	134,019	-1,340	132,679	29,506	-295	29,211
Totali i vleres se mbetur	134,019	-1,340	132,679	29,506	-295	29,211

Me 31 Dhjetor 2014 kredite dhe paradheniet ndaj klienteve jane provizionuar vetem kolektivisht, pasi asnje nga kredite nuk rezultoi e zhvleresuar.

Hua dhe paradhenie klienteve të zhvlerësuar individualisht

Hua te zhvlerësuar individualisht janë ato hua për të cilat "Tirana Factoring & Lease" sha ka përcaktuar se është e mundur që ajo mos të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe të principalit në bazë të kushteve të kontratës të huasë.

Fondi për humbje nga zhvlerësimi

"Tirana Factoring & Lease" sha krijon një fond për humbjet nga zhvlerësimi i kredive që përfaqëson vlerësimin për humbjet e ndodhura në portofol. Përbërësit kryesorë të këtij provizion janë, komponenti për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme, dhe një provizion të përgjithshëm për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësim.

Politika e fshirjes se humbjeve

Fshirja e humbjeve bëhet me vendim nga Drejtimi kur procesi ligjor për ripagimin e huase ka përfunduar dhe klienti vazhdon të mbetet debitor ndaj "Tirana Factoring & Lease" sha për pjesen e papaguar të huasë.

"Tirana Factoring & Lease" sha monitoron riskun e përqendrimit të kredisë sipas sektorëve.

3.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që "Tirana Factoring & Lease" sha nuk do të permbushë pagesën e angazhimeve që lindin nga detyrimet financiare.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i ProFactoring Albania në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të riskojë të dëmtojë emrin e mire.

Drejtimi rishikon vazhdimisht situatën e likuiditetit të "Tirana Factoring & Lease" sha dhe bën rekomandimet përkatëse.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Mënyrat kryesore të përdorura nga "Tirana Factoring & Lease" sha për administrimin e riskut të likuiditetit janë raportet e likuiditetit dhe vlerësimi i hendekut për periudha specifike.

Luhatshmeria në tregjet financiare globale dhe shqiptare

Vazhdimi i krizes financiare dhe ekonomike botërore ka ndikim midis të tjerash edhe mbi zvogëlimin e tregjeve kapitale, uljen e likuiditetit në sistemin bankar dhe, në momente specifike, edhe në rritjen e interesit të kreditimit ndërbankar dhe luhatshmerine e tregjeve të letrave me vlerë. Zhvillime të tjera jo të favorshme



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

të krizës mund të ndikojnë negativisht mbi pozicionin financiar dhe likuiditetin e "Tirana Factoring & Lease" sha .

Maturitetet kontraktuale të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare

Maturitetet kontraktuale të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare me:

31 dhjetor 2014	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Totali
	LEK '000	LEK '000	LEK '000	LEK '000	LEK '000
Aktivet Financiare					
Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to	18,052	-	-	-	18,052
Hua dhe paradhënie klientëve	1,656	114,839	16,104	-	132,599
Aktive të tjera	4	-	-	213	217
Totali	19,713	114,839	16,104	213	150,868
Detyrime financiare					
Detyrime ndaj ortakeve	0	114,486	-	0	114,486
Detyrime ndaj klientëve	-	-	-	-	0
Detyrime të tjera	233	1,366	-	-	1,599
Totali	233	115,852	0	0	116,086
Risku i likuiditetit më 31 dhjetor 2014	19,480	-1,014	16,104	213	34,783
Kumulativi	19,480	18,466	34,570	34,783	0

Dhe me:

31 dhjetor 2013	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Totali
	LEK '000	LEK '000	LEK '000	LEK '000	LEK '000
Aktivet Financiare					
Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to	4,511	-	-	-	4,511
Hua dhe paradhënie klientëve	11,062	13,059	5,089	-	29,211
Aktive të tjera	-	-	-	-	0
Totali	15,573	13,059	5,089	0	33,722
Detyrime financiare					
Detyrime ndaj ortakeve	1,083	10,795	-	0	11,878
Detyrime ndaj klientëve	-	-	-	-	0
Detyrime të tjera	-	-	-	-	0
Totali	1,083	10,795	0	0	11,878
Risku i likuiditetit më 31 dhjetor 2013	14,490	2,263	5,089	0	21,843
Kumulativi	14,490	16,754	21,843	21,843	0



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

3.4 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit dhe normat e kursit të këmbimit do të ndikojë në të ardhurat e "Tirana Factoring & Lease" sha apo vlerën e instrumentave financiarë.

Administrimi i rrezikut të tregut

Normat e aplikueshme e këmbimit (1 njësi e monedhës së huaj është e barabarte me kaç Lek) për monedhat kryesore në 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
USD	115.23	101.86
EUR	140.14	140.20

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

"Tirana Factoring & Lease" sha e administron rrezikun duke mbyllur pozicionet e hapura si dhe duke vendosur dhe monitoruar limite mbi pozicionet e hapura. "Tirana Factoring & Lease" sha administron rrezikun e normave të interesit duke përdorur analizën e rishmimit të hendekut dhe analizën e marzhit të fitimit për secilën nga monedhat kryesore.

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas monedhave ne te cilat ato shprehen, për 31 dhjetor 2014 është si më poshtë:

Rrisku valutor

	LEK	USD	EURO	Të tjera	Totali
	LEK'000	LEK '000	LEK '000	LEK '000	Lek '000
31 Dhjetor 2014					
Aktive					
Aktivët monetarë dhe ekuivalentët me to	2,437	5	15,610	-	18,052
Hua dhe paradhënie klientëve	40,687	35,052	56,859	-	132,598
Aktive të tjera	368			-	368
Totali	43,492	35,058	72,470	0	151,019
Detyrime					
Detyrime ndaj ortakeve	14,500	34,569	65,417	-	114,486
Detyrime të tjera	1,599			-	1,599
Kapitali	34,934				34,934
Totali	51,033	34,569	65,417	0	151,019
Pozicioni neto më 31 Dhjetor 2014	-7,541	489	7,052	0	0

	LEK	USD	EURO	Të tjera	Totali
	LEK'000	LEK '000	LEK '000	LEK '000	Lek '000
31 Dhjetor 2013					
Aktive					
Aktivët monetarë dhe ekuivalentët me to	3,598		672	-	4,271
Hua dhe paradhënie klientëve	17,934		11,276	-	29,211
Aktive të tjera	312			-	312
Totali	21,846	0	11,949	0	33,795
Detyrime					
Detyrime ndaj ortakeve			11,179	-	11,179
Detyrime të tjera	698			-	698
Totali	698	0	11,179	0	11,878
Pozicioni neto më 31 Dhjetor 2013	21,147	0	769	0	21,916



Tirana Factoring & Lease Sh.a

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

3.4 Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj Rrezikut të Normes së Interesit

Një përmbledhje e pozicionit neto të interesit të "Tirana Factoring & Lease" sha, të përfshirë në vlerën e mbetur, dhe kategorizuar sipas rëqimimit kontraktual më të hershëm ose datave të maturimit, më 31 Dhjetor 2014 vijon si më poshtë:

	Deri në 1 muaj LEK '000	1-3 muaj LEK '000	3-6 muaj LEK '000	1-5 vjet LEK '000	Mbi 5 vjet LEK '000	Nuk mbartin interes LEK '000	Vlera e mbetur LEK '000
31 dhjetor 2014							
Aktivet financiare							
Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to						18,052	18,052
Hua dhe paradhënie klientëve	0	116,079	16,267			1,673	134,019
Aktive të tjera	-					368	368
Totali i aktiveve	0	116,079	16,267	0	0	20,094	152,439
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj ortakeve						114,486	114,486
Detyrime ndaj klientëve							0
Detyrime të tjera						1,599	1,599
Totali i detyrimeve	0	0	0	0	0	116,085	116,085
Gap-i më 31 Dhjetor 2014	0	116,079	16,267	0	0	-95,991	36,354

	Deri në 1 muaj LEK '000	1-3 muaj LEK '000	3-12 muaj LEK '000	1-5 vjet LEK '000	Mbi 5 vjet LEK '000	Nuk mbartin interes LEK '000	Vlera e mbetur LEK '000
31 dhjetor 2013							
Aktivet financiare							
Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to						4,271	4,271
Hua dhe paradhënie klientëve	11,174	13,191	5,140			-295,	29,211
Aktive të tjera	-					312	312
Totali i aktiveve	11,174	13,191	5,140	0	0	4,288	33,795
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj ortakeve	-	10,795				384,308	11,179
Detyrime ndaj klientëve	-						0
Detyrime të tjera	-					698,979	698
Totali i detyrimeve	0	10,795	0	0	0	1,083,287	11,878
Gap-i më 31 Dhjetor 2013	11,174	2,395	5,140	0	0	3,205	21,916



Tirana Factoring & Lease SH.A.

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(shumat ne mije Lek, kur nuk eshte shprehur ndryshe)

3.5 Administrimi i kapitalit

Shoqeria e administron kapitalin e saj duke siguruar vijimesine e aktiviteve te saj duke maksimizuar kthimin e aksionereve permes optimizimit te teprices se borxhit dhe asaj te kapitalit te vet. Gjendja e kapitalit dhe raportit te borxhit te "Tirana Factoring & Lease" sha me 31 dhjetor 2014 dhe 2013 ka qene si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013 LEK
Huamarrja totale	116,085,631	11,878,688
Minus: Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to	-18,052,399	-4,271,505
Detyrime neto	98,033,232	16,150,193
Totali i Kapitalit Aksionar	34,933,618	21,916,543
Kapitali aksionar/detyrime neto	36%	136%

3.6 Dhenia e informacioneve shpjeguese mbi vleren e drejte

Percaktimi i vleres se drejte bazohet mbi instrumentat financiare ekzistues te pasqyres te pozicionit financiar, pa u perpjekur per te aktualizuar vleren e bizneseve te ardhshme dhe vleren e aktiveve dhe detyrimeve te cilat nuk jane instrumenta financiare.

Kreditë e dhëna klientëve - Kreditë e dhëna klientëve mbahen neto duke u zbritur humbjet për çvlerësim. Portofoli i kredive të "Tirana Factoring & Lease" sha ka një vlerë të drejtë të përlogaritur afërsisht sa vlera kontabël si pasojë e natyrës afat-shkurtër ose normave të interesit (te cilat variojnë mbi: Bonot Thesari, LIBOR plus një marzh interesi), të cilat i përafrohen normave të tregut. Shumica e portofolit të kredive është subjekt i riqmimit brenda vitit, duke ndryshuar interesin bazë.

Detyrime ndaj bankave të tjera dhe klienteve - Vlera e drejtë e depozitave pa afat, të cilat përfshijnë depozita pa interes, është shuma që do të paguhej sipas kërkesave.

Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllimin e dhënies së shenimeve shpjeguese.

4. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013 LEK
Të ardhura nga interesat		
Hua	8,169,750	1,344,853
Llogari dhe depozita bankare	5,636	399,539
Interes i perlogaritur mbi huate		166,059
Totali i të ardhurave nga interesat	8,175,386	1,910,451
Shpenzime për interesat		
Te tjera	0	
Shpenzime interesi per hua nga ortaket	0	-427,015
Totali i shpenzimeve për interesat	0	-427,015
Të ardhura neto nga interesat	8,175,386	1,483,436



Tirana Factoring & Lease SH.A.

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(shumat ne mije Lek, kur nuk eshte shprehur ndryshe)

Në të ardhurat nga interesat janë përfshirë interesat nga kontratat faktoring si dhe interesat bankare, ndersa shpenzimet per interesa perfaqesojne interesat e paguara per huate e marra ne funksion te aktivitetit te shoqerise.

5. Të ardhura dhe shpenzime nga tarifat dhe komisionet

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Te ardhura nga tarifat dhe komisionet		
Tarifa huaje	4,323,761	1,117,938
<i>Totali i te ardhurave nga tarifa dhe komisionet</i>	4,323,761	1,117,938
Shpenzime tarifash dhe komisionesh	-41,537	-20,944
Te ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet	4,282,224	1,096,994

Komisionet dhe tarifat nga aktiviteti huadhënës përveç komisioneve të përfshira këtu, përfshihen në përcaktimin e normës efektive të interesit të huave dhe paradhënies për klientët me kosto të amortizuar.

6. Hua dhe paradhënie ndaj klientëve

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve	132,345,463	29,340,233
Llogari te Arketueshme (interes)	1,673,368	166,059
Zbritje per zhvleresimin e huave dhe paradhanie	-1,420,200	-295,063
Vlera neto e huave dhe paradhanieve ndaj klienteve	132,598,631	29,211,229
	31 dhjetor 2013 LEK	31 dhjetor 2012 LEK
Provizione per huate		
Gjendja në fillim të vitit	295,063	0
Shpenzimi për humbjen nga zhvlerësimi	1,125,137	295,063
Total provizione	1,420,200	295,063
Te arketueshme nga huate		
	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Deri ne 1 muaj	1,673,368	11,174,294
Nga 1 deri ne 3 muaj	116,078,733	13,191,050
Nga 3 deri 6 muaj	16,266,730	5,140,948
	134,018,831	29,506,292



Tirana Factoring & Lease SH.A.

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(shumat ne mije Lek, kur nuk eshte shprehur ndryshe)

7. Aktive Afat Gjata

Aktive Afatgjata	Pajisje zyre dhe informatike	Te tjera	Program Kontabiliteti	Totali
Kosto 01.01.2014	81,100		0	81,100
Shtesa	5,000		112,777	117,777
Pakesime				0
Gjendje 31.12.2013	86,100		112,777	198,877
Amortizimi				
Amortizimi 01.01.2014	-8,499		0	-8,499
Shtesa	(18,150)		(21,242)	-39,392
Pakesime				0
Gjendje 31.12.2014	-26,649		-21,242	-47,891
Vlera neto 01.01.2014	72,601		0	72,601
Vlera neto 31.12.2014	59,451		91,535	150,986

Aktive Afatgjata Materiale & Jomateriale jane prone e shoqerise dhe priten perfitime te ardhshme nga perdorimi i tyre.

8. Shpenzime personeli

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Paga	-1,908,736	-1,693,318
Sigurime shoqërore	-309,167	-237,777
Të tjera	0	0
Total	-2,217,903	-1,931,095

9. Shpenzime administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Mirëmbajtje dhe riparime	-46,000	-35,000
Sherbime te tjera	-193,260	-41,720
Shpenzime postare e telekomunikacion	-69,663	-8,220
Tatime te tjera (TVSH)	0	-20,440
Shpenzime pritje dhe dhurata	-157,000	-96,240
Taksa dhe tarifa vendore	-25,120	-25,120
Qera	-180,000	0
Gjoha	-10,000	0
Shpenzime perfaqesime, publicitet	-15,000	0
Energji, uje etj	-148,010	-11,037
	-844,053	-237,777



Tirana Factoring & Lease SH.A.

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(shumat ne mije Lek, kur nuk eshte shprehur ndryshe)

10. Tatim mbi fitimin

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Tatim aktual	-1,441,793	-40,587
Tatimi i shtyrë (përfitim)/-shpenzim	213,030	0
Tatimi mbi fitimin	-1,228,763	-40,587

Ne perputhje me rregulloret tatimore shqiptare, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin per vitin 2014 eshte 15% (2013: 10%). Rakordimi i normes efektive te tatim fitimit permblidhet si me poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Fitimi para tatimit	8,245,838	638,460
Tatimi i përlogaritur me 15%	1,236,876	63,846
Kthimi i aktivitetit tatimor te shtyre te vitit te shkuar (humbje e mbartur)	0	-38,627
Shpenzime të pazbrishme	1,366,117	153,680
Tatimi i përlogaritur me 15%	204,918	15,368
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	1,441,793	40,587

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit tek Autoritet Tatimore por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllime fiskale konsiderohen provizore derisa deklaratat tatimore dhe llogaritjet e tatimit të inspektohen autoritetet tatimore dhe një vlerësim final të lëshohet. Legjislacioni shqiptar mbi tatimin është subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore.

11. Aktiv tatimor i shtyre

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Fonde rezerve per mbul. e humbjeve nga huate	1,420,200	0
Aktiv tatimor i shtyre	213,030	0
Total	213,030	0

12. Fitim Humbja e Pashperndare

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Fitime e humbje te pashperndara		
Gjendja në 1 janar	-83,457	0
Rritja gjatë vitit	7,017,075	-83,457
Gjendja në 31 dhjetor	6,933,618	-83,457



Tirana Factoring & Lease SH.A.

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(shumat ne mije Lek, kur nuk eshte shprehur ndryshe)

13. Aktive të tjera

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
TVSH e arkëtueshme	0	0
Detyrime nga aksionerët	0	0
Debitore te tjere	4,203	10,000
Te tjera te arketueshme	0	229,896
Total	4,203	239,896

15. Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Aktive monetare në arkë	0	3,500
Llogari rrjedhese ne banke ne monedhe vendase	2,436,752	3,595,334
Llogari rrjedhese ne banke ne monedhe te huaj	15,615,646	672,671
Total	18,052,399	4,271,505

16. Kapitali aksioner

Me date 16.10.2014 eshte depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit vendimi i asamblese se ortakeve, date 13.10.2014 ku eshte vendosur ndryshimi i formes ligjore te shoqerise "ProFactoring Albania" nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k) ne shoqeri aksionere (sh.a) si dhe ndryshimi i statutit te shoqerise.

Me date 31.10.2014 eshte depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit vendimi i asamblese date 30.10.2014, ku eshte vendosur ndryshimi i emrit tregtar te shoqerise nga "ProFactoring Albania" shpk dhe me pas "Tirana Credit", me date 31.10.2014 u bë "Tirana Factoring & Lease" sha.

Referuar vendimit te Asamblese se Pergjitheshme te aksionereve nr.7 date 15.12.2014, eshte realizuar zmadhimi i kapitalit aksioner me Shumen 6,000,000 (gjashtemilion) leke, me kontribute ne para. Per kete qellim aksioneret kane paraqitur ne shoqeri deklaratat per burimin e te ardhurave te perdorura per zmadhimin e kapitalit si dhe dokumentacionin per tatimin e dividendit apo te tatimit mbi te ardhurat nga mardhenia e punes. Ky dokumentacion eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me date 22.12.2014. Sa me lart kapitali aksioner ishte I perbere nga 220,000 askione te zakonshme dhe pas zmadhimit u be 280,000 aksone, me vlere nominale 100 leke per aksion. Ndryshimet ne numrin dhe kapitalin e investuar jane paraqitur ne tabelat e meposhteme.



Tirana Factoring & Lease SH.A.

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(shumat ne mije Lek, kur nuk eshte shprehur ndryshe)

Kapitali aksioner

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2014			Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013		
	Nr. Aksionesh	Vlera ne Leke	Ne %	Nr. Aksionesh	Vlera ne Leke	Ne %
Roland Manushi	112,000	11,200,000	40%	88,000	8,800,000	40%
Ervin Aliaj	112,000	11,200,000	40%	88,000	8,800,000	40%
Endrit Beqaj	56,000	5,600,000	20%	44,000	4,400,000	20%
	280,000	28,000,000	100%	220,000	22,000,000	100%

Nr. i aksioneve

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
	Nr.	Nr.
Në fillim të vitit	220,000	200,000
Rritje në numrin e aksioneve	60,000	20,000
Në fund të vitit	280,000	220,000
Vlera nominale per aksion ne LEK	100	100

17. Hua nga bankat dhe te tjera

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
	LEK	LEK
Detyrime ndaj bankave:	0	0
Banka residente	0	0
Banka te huaja	0	0
Palet e treta:	114,486,344	11,179,708
Roland Manushi Hua	0	10,795,400
Roland Manushi interesa	0	384,308
Manushi Sh.p.k	80,063,944	0
Ervin Aliaj	1,300,000	0
Fatos Aliaj	33,122,400	0
Total	114,486,344	11,179,708

18. Detyrime të tjera

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
	LEK	LEK
Detyrime ndaj punonjesve	50,111	339,952
Detyrime ndaj furnitoreve	115,412	42,731
Detyrime te tjera	4,178	214,216
Total	169,701	596,899



Tirana Factoring & Lease SH.A.

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(shumat ne mije Lek, kur nuk eshte shprehur ndryshe)

19. Detyrime tatimore

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
	LEK	LEK
Detyrime per sigurime shoq. e shendetesore	43,509	40,703
Detyrime ndaj shtetit per tatim mbi paga	19,945	14,590
Detyrime ndaj shtetit per tatim fitimi	1,366,133	587
Detyrime ndaj shtetit per tatim ne burim	0	46,201
Total	1,429,587	102,081

20. Transaksionet me palët e lidhura

	31 dhjetor 2014			31 dhjetor 2013		
	Drejtuesit	Palë të tjera të lidhura	Totali	Drejtuesit	Palë të tjera të lidhura	Totali
	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK
Aktivët në fund të vitit						
Mjete monetare (derdhje kapitali)		6,000,000	6,000,000		20,000,000	20,000,000
Llogari rrjedhese			0			0
Paradhënie		4,203	4,203		10,000	10,000
Aktive të tjera			0			0
Total	-	6,004,203	6,004,203	-	20,010,000	20,010,000
Detyrimet ne fund te vitit			0			0
Detyrime per hua		114,486,352	114,486,352		10,835,600	10,835,600
Detyrime te tjera			0			0
Total	-	114,486,352	114,486,352	-	10,835,600	10,835,600
Trasaksionet për vitin e mbyllur			0			0
Të ardhura nga interesat e depozitave me afat			0			0
Shpenzime interesash nga huatë me bankat			0			0
Shpenzime interesi		0	0		0	0
Të ardhura nga interesat nga qeratë financiare dhe kreditë			0		427,015	427,015
Pagesat e qerave			0			0
Total	-	0	0	-	427,015	427,015



Tirana Factoring & Lease SH.A.

Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(shumat ne mije Lek, kur nuk eshte shprehur ndryshe)

Pervec ketyre, shperblimi per drejtuesit e shoqerise ka qene si vijon:

	31 dhjetor 2014			31 dhjetor 2013		
	Drejtuesit	Palë të tjera të lidhura	Total	Drejtuesit	Palë të tjera të lidhura	Total
	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK
Paga		1,141,560	1,141,560		1,119,630	1,119,630
Shperblime			0			0
Total	0	1,141,560	1,141,560	0	1,119,630	1,119,630

21. Ngjarjet pas dates se bilancit

Drejtimi I shoqerise nuk eshte ne dijeni te ngjarjeve qe ndodhin pas dates se bilancit dhe qe kerkojne rregullime ose shtesa ne shenimet shoqeruese te pasqyrave financiare.

Tirane ne 12 Shkurt 2015

Endrit Beqaj
Administrator

Ervin Kosta
Specialist Finance

Endrit Beqaj

Ervin Kosta

